



Projekt i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

INDEKSI I MBROJTJES SË FËMIJËS 2.0

PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE

www.childprotectionindex.org



Zbatuar nga Koalicioni i OJQ-ve për
Mbrotjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF

Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijës është një mekanizëm i pavarur i shoqërisë civile për matjen e reformave të çdo vendi në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës. Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijës 2.0 është publikuar nga KOMF në Janar 2018.

Indeksi ka vlerësuar pesë dimensione të veprimeve të Kosovës që i referohen mbrojtjes së fëmijës. Këto pesë dimensione janë: politikat dhe ligjet, shërbimet, kapaciteti, koordinimi dhe llogaridhënia.

Koalicioni i OJQ–ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, bazuar në misionin për avokimin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, përmes këtij dokumenti adreson rekomandimet kryesore të dala nga Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijës për fushat më kritike të cilat kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme.

Indeksi vë në pah se Kosova ka një boshllëk të madh mes legjislacionit të miratuar dhe zbatimit të tij. Presim që qeveria, komunat, donatorët dhe pjesëtarët e shoqërisë civile të mund të përdorin rekomandimet nga Indeksi në rritjen e ofritit të shërbimeve, kapacitetit institucional, koordinimit dhe llogaridhënies, për mbylljen e hendekut midis legjislacionit dhe zbatimit të tij.

Dokumentin e plotë të Indeksit të Mbrojtjes së Fëmijës 2.0, mund ta gjeni në këtë vegëz:

<http://www.komfkosova.org/ëp-content/uploads/2018/01/Raporti-shqip.pdf>

Ky dokument mundësohet nga projekti “Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë”, financuar nga Bashkimi Evropian, udhëhequr nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatuar nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijës KOMF.

Përmbajtja dhe pikëpamja e këtij dokumenti janë përgjegjësi e vetme e Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian.

REKOMANDIMET

Qeverisja e mirë

- Operacionalizimi dhe fuqizimi i mekanizmave koordinues në nivel qendror si: Këshilli për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë, Komiteti i Kosovës për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve dhe Autoriteti Kombëtar kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore;
- Shkrimi dhe mekanizmi koordinues për mbrojtjen e fëmijëve në nivel lokal, në një mekanizëm;
- Sigurimi i financimit të qëndrueshëm dhe adekuat për shërbimet sociale në Kosovë përmes ndryshimit të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe krijimin e një Granti Specifik për Shërbime Sociale;
- Miratimi i standardeve financiare në harmoni me standardet e cilësisë. Pa vendosjen e standardeve financiare është e vështirë të sigurohen buxhete të qëndrueshme dhe të mjaftueshme për shërbimet;
- Krijimi i mekanizmave të jashtëm dhe të pavarur të inspektimit për të shqyrtuar cilësinë e shërbimeve të ofruara (private e publike) dhe për të administruar licencimin;
- Planifikimi dhe zbatimi i procesit të licencimit të detyrueshëm për shërbimet publike të ofruara nga QPS ose autoritetet e tjera publike;
- Sigurimi i proceseve për pjesëmarrjen e fëmijëve në çdo proces vendimmarrës për fëmijët;
- Hapja e një linje të re telefonike pa pagesë, të dizajnuar me dhe për fëmijët. Shërbimi duhet të pranohet telefonat dhe të ofrojë mbështetje, këshillim për fëmijët në situata të dhunës, abuzimit, neglizhimit, abuzimit me substanca narkotike, rrëmbimit, trafikimit dhe formave të tjera të shfrytëzimit;
- Hulumtimi dhe grumbullimi i të dhënave duhet të konsolidohen për të përcaktuar numrin e fëmijëve për secilën komunë, numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijët e përfshirë në punë, fëmijët viktimë të abuzimit me narkotikë etj.

Parandalimi i dhunës dhe shfrytëzimit

Të gjitha format e dhunës

- Vetëdijësimi në nivel nacional drejtuar popullatës së gjerë dhe institucioneve për mbrojtjen e fëmijëve, për të promovuar metodat pozitive të prindërimit dhe disiplinimit dhe për të eliminuar metodat e dhunshme të disiplinimit dhe ndëshkimit trupor;
- Zhvillimi i programeve të prindërimit të disiplinës pozitive për prindërit, kujdestarët dhe profesionistët që punojnë në mbrojtje të fëmijëve, për të zvogluar praktikën e dhunshme për disiplinimin dhe mirërritjen e fëmijëve, duke krijuar një brez të ri gjeneratash jo të dhunshëm;
- Promovimi më tej i raportimit mes bashkëmoshatarëve dhe vetë raportimit, përmes veprimeve që rrisin ndërgjegjësimin tek fëmijët dhe të rinjtë;
- Organizimi i trajnimeve dhe fushatave vetëdijësuese për t'i përkujtuar zyrtarëve shtetëror dhe profesionistëve për detyrën e tyre për të raportuar rastet e dhunës së dyshuar ndaj fëmijëve;
- Rritja e kapaciteteve dhe investimeve financiare në shërbimet sociale për zbatimin e politikave, ligjeve dhe rregulloreve për identifikimin, rehabilitimin dhe re-integrimin e fëmijëve në rrezik dhe viktimë të dhunës;

- Rritja e kapaciteteve të profesionistëve të arsimit për zbatimin e protokollit për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para - universitar;
- Shtrirja e trajnimeve për menaxhimin e rasteve tek sektorët e arsimit, shëndetësisë dhe drejtësisë në mënyrë që ata të njihen me procedurat standarde të veprimit për viktimat e dhunës;

Shfrytëzimi ekonomik / Puna e rëndë

- Rritja e burimeve dhe kapaciteteve të institucioneve (QPS, Inspektorati i Punës), për të identifikuar rastet e fëmijëve të përfshirë në punë të rrezikshme, duke përfshirë zonat më të largëta rurale ku aktualisht shërbimet nuk janë të qasshme;
- Riaktivizimi i mekanizmave, me qëllim të rritjes së identifikimit dhe zhvillimit të mekanizmave të duhur të raportimit për të plotësuar bazën e të dhënave në nivel nacional të ndarë sipas gjinisë, moshës, llojit të punës;
- Themelimi dhe zhvillimi i shërbimeve bazë për fëmijët e përfshirë në punë të rënda është një masë e menjëhershme që qeveria dhe komunat duhet të ndërmarrin;
- Themelimi i ekipeve mobile për shërbimet për fëmijët në mënyrë që ti identifikojnë, të ofrojnë shërbime, si dhe të krijojnë plane individuale për secilin prej tyre;
- Krijimi i një baze të dhënash në nivel nacional me shifra përkatëse të ndara sipas komunave përkatëse, moshës dhe gjinisë për fëmijët viktimat të shfrytëzimit ekonomik dhe fëmijët të përfshirë në punë të rënda;

Shfrytëzimi seksual

- Ndryshimi i Kodit Penal që puna me fëmijë e personave të dënuar për vepra të dhunshme dhe abuzim seksual ndaj fëmijëve, të ndalohet;
- Kontrolli i historikut penal për të gjithë personat që punojnë me fëmijë;
- Të njihet ligjërisht shfrytëzimi i fëmijëve përmes “telefonatave seksuale” përmes Kodit Penal dhe të ndalohet shfrytëzimi i tillë;
- Fuqizimi i mekanizmave për identifikim dhe raportim që do të lehtësojnë vetë-raportimin, raportimin e bashkëmohatarëve dhe qasjen në raportim të profesionistëve;
- Rritja e numrit të vendeve të cilat mundësojnë vetë raportimin dhe raportimin e bashkëmohatarëve në situata të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual;

Trafikimi

- Rritja e stafit profesional për të ofruar shërbime, për të siguruar qasjen multidisiplinare;
 - Reformimi dhe ristrukturimi i QPS për të ndërtuar një sistem për t’ju përgjigjur çënueshmërive të caktuara, duke ndarë menaxhimin e rasteve të fëmijëve dhe rasteve të të rriturve;
 - Caktimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve të posaçëm për të trajtuar rastet e trafikimit; dhe në koordinim me policinë, për të identifikuar dhe ndihmuar fëmijët që i nënshtrohen detyrimit për kërkim lëmshës;
 - Autoritetet e drejtësisë penale në Kosovë t’i japin prioritet hetimeve dhe ndjekjeve penale të trafikantëve të dyshuar për të ndërtuar raste të forta dhe maksimizuar dënimet kurdo që është e mundur;
-

- Ofrimi i trajnimeve të avancuara për zyrtarët që merren me hetimet dhe ndjekjet e trafikimit për të identifikuar dhe ndihmuar fëmijët që i nënshtrohen detyrimit për kërkim lëshohë;
- Mbledhja e të dhënave dhe krijimi i një bazë të dhënash për të siguruar statistika të ndara për trafikimin dhe dënimet lidhur me trafikimin me fëmijë;
- Zbatimi në tërësi i Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit;

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara

- Ndryshimi i Ligjit për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme për të përfshirë mbrojtje gjithëpërfshirëse për të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar;
- Sponsorizimi i shërbimeve sociale të bazuara në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara përmes nën-kontraktimit të OJQ-ve lokale që u përgjigjen nevojave të veçanta të tyre në ofrimin e shërbimeve të përditshme psiko-sociale, të socializimit, rehabilitimit dhe riintegrit;
- Garantimi i shërbimeve cilësore shëndetësore për fëmijë me aftësi të kufizuara, sigurimi i rregullt i barnave, materialeve shpenzuese dhe pajisjeve të domosdoshme për këta fëmijë;
- Përshtatja e buxheteve me planet që mbështesin infrastrukturën fizike, asistentët, ngritjen e kapaciteteve për mësimdhënës dhe nevojat e transportit të fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Rritja e stafit profesional në arsimin gjithëpërfshirës, përcaktimi i kodit buxhetor për ndihmën e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor;
- Heqja e barrierave të qasjes publike, transportit, komunikimit, informatave në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë qasje në arsim të duhur dhe në jetën shoqërore;
- Mbledhja e të dhënave dhe zhvillimi i një bazë të të dhënave në nivel nacional për fëmijët me aftësi të kufizuara me të dhëna të ndara sipas moshës, gjinisë, llojeve të aftësisë së kufizuar dhe komunës;

Strehimi familjar për fëmijët pa përkujdes prindëror

- Zgjerimi i strehimit familjar në të gjitha komunat në Republikën e Kosovës;
- Rritja dhe kategorizimi i pagesës për familjet strehuese bazuar në moshën, kategoritë dhe nevojat e fëmijëve pa përkujdes prindëror të vendosur në strehim familjar;
- Kategorizimi i familjeve strehuese për nevojat e ndryshme të fëmijëve;
- Vazhdimi i pagesës për familjet strehuese edhe gjatë muajve kur ata nuk kanë fëmijë të strehuar, në shumë më të vogël (për shembull 50% të shumës së rregullt mujore), me qëllim të ruajtjes së tyre;
- Ofrimi i përfitimeve sociale dhe shëndetësore për familjet strehuese për të ndihmuar në mbulimin e shpenzimeve të tyre që lidhen me kujdesin e fëmijës/ve të strehuar;
- Përfshirja e strehimit familjar si një profesion i njohur brenda skemës tatimore dhe pensionale;

Adoptimi

- Ndryshimi i Ligjit për Familjen për të ndaluar adoptimin e fëmijëve nga personat që kanë qenë të përfshirë në akte të paligjshme gjatë marrjes ose sjelljes së një fëmije për qëllime adoptimi;
- Ndryshimi i Ligjit për Familjen për përcaktimin e afateve ligjore për procedurat e adoptimit me qëllim ku-fizimin e vonesave të panevojshme në zgjidhjen e statusit të fëmijëve dhe vendosje në adoptim;
- Ndryshimi i Ligjit për Familjen për përcaktimin e moshës së prindit/ve potencial adoptues dhe diferencës në moshë më fëmijën;
- Monitorimi dhe inspektimi i QPS-ve gjatë menaxhimit të rasteve të fëmijëve të braktisur, për evitimin e vonesave të panevojshme gjatë zgjidhjes së statusi të tyre;
- Kryerja e një monitorimi periodik pas përfundimit të periudhës provuese të adoptimit për të siguruar një ambient të qëndrueshëm dhe mbrojtës për fëmijën dhe prindërit adoptues;
- Vetëdijësimi i publikut për nevojat dhe diskriminimin me të cilin përballen fëmijët me aftësi të kufizuara që presin për adoptim.

Mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi me narkotikë

- Ashpërsimi i dënimeve në Kodin Penal për shkeljet që kanë të bëjnë me narkotikë të kryera nga të rriturit ku fëmijëve u janë shitur ose u janë dhënë narkotikë;
- Përcaktimi i moshës minimale 18 vjeç për blerjen e alkoolit në të gjitha ambientet dhe ndalimi i shitjes së substancave tretëse fëmijëve;
- Prioritizimi i mbrojtjes së fëmijëve viktimë të abuzimit me narkotikë nëpërmjet krijimit, sponsorizimit dhe zhvillimit të shërbimeve në nivel shtetëror që mundësohen nga ofruesit shtetëror dhe privat;
- Zhvillimi i programeve të identifikimit dhe reintegrimit në përgjigje ndaj nevojave të fëmijëve viktimë të abuzimit me substanca narkotike dhe familjeve të tyre;
- Mbledhja e të dhënave për nivelin e abuzimit me narkotikë në nivel nacional;

Tortura dhe çdo trajtim ose dënim tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtërues ndaj fëmijëve

- Plotësim ndryshimi i Kodit të Drejtësisë për të Mitur, për të shkurtuar paraburgimin për fëmijët, në gjashtë muaj;
- Ndarja e fëmijëve nga të rriturit në të gjitha objektet institucionale, duke përfshirë edhe ato korrektuese;
- Ndërmarrja e vizitave të rregullta në qendrat korrektuese nga gjyqtarët me qëllim të krijimit të llogaridhënies së nevojshme për procesin e trajtimit dhe reintegrimit të çdo të mituri;
- Rritja e stafit profesional në institucionet edukative dhe korrektuese dhe rritja e kapaciteteve të tyre për të punuar me të mitur;
- Ulja e numrit prej 20 të miturve në maksimum 10 të mitur në një grup me një edukator;
- Qasja e të miturve në sistemin e rregullt arsimor jashtë Qendrës Korrektuese ashtu si kërkohet nga ana e Kodit të Drejtësisë për të Mitur;
- Krijimi i mekanizmit të jashtëm për ankesa për të rritur besimin e të miturve, për të fuqizuar të drejtën e të miturve që t'i mbajnë përgjegjës zyrtarët dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre.

Organizatat anëtare të KOMF:

Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim – ASTRA, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, Balkan Sunflowers Kosova, Childproof/CIPOF, Education Comes First – ECF, Edukimi për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kosovë – KESD, Iniciativa 6, Organizata Rinore Akti – ORA, One To One Kosova, Qendra e Këshillimit për Familje – QKF, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, OPFAKKOS, Programi për të Drejtat Civile – CRP/K, PL4Y International, Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, Qendra e Kujdesit Ditor PEMA, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me qenie njerëzore – MVPT, Qendra për Studime të Avancuara – FIT, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT, Save the Children, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë – SDSF, Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK Kosova, Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës – HANDIKOS, Terre des hommes, The Ideas Partnership, VoRAE dhe World Vision.
